



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:073867

Datë: 08.06.2020

Numri i dokumentit: 00948835

P.nr.102/19

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
DIVIZIONI PENAL** Sipas gjyqtarit Refki Piraj, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Halime Nixha, në lëndën penale kundër të pandehurit A.B nga Prizren, me numër personal ..., për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit PP.nr.2485-4/18 e dt. 23.01.2019 ne pranin e Prokurorit të Shtetit Naim Gashi, të pandehurit A.B, me datë 08.06.2020 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.B i lindur më, me numër, i biri i F. B dhe nënës L.K, me vendbanim në... , Prizren, Rr Pn i i pa martuar, i pa pune i gjendjes së dobët ekonomike shqiptar shtetas i R të Kosoves.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me date 25.09.2018, rreth orës 00:20 min ne Prizren ne rr. ... pa autorizim ka poseduar narkotik, substancë psikotrope apo analoge ne atë mënyrë qe gjate kontrollit nga Njësia patrulluese e Stacionit policore ne Prizren, ne veture i është gjetur nje qese plastike e mbyllur me substance te ndryshuar për narkotik te llojin “Marihuana” ku nga ekzaminimi laboratorik i forenzikes është konstatuar se ka pas ne posedim substance narkotike te llojit marihuanë ne peshe prej 07.19 gr.

Këso dore ka kryer veprën posedim i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KP-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 43,49, 50 . 51, 52, 62, 69, 73 te KP t e akuzuarit i shqipton :

D Ë N I M M E G J O B E

Ne shume prej 200 (dyqind) euro te cilin dënim do ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykata nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e poqe se dënimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarit ne afatin ligjore i njëjti do te zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur 20 euro për 1 dite burg gjegjësisht 10 dite burg.

Dhe

DËNIM ME KUSHT

Me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muaj cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (nje) viti, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen veprë te re penale.

DENIMI PLOTESUES

Konfiskohet substanca narkotike substance narkotike te llojit marihuanë ne peshe prej 07.19 gr. si mjet i kryerjes se veprës penale.

Obligohet I pandehuri qe ti paguajnë te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, kurse ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm.

Ne zbatim te ligjit mbi mbrojtjen e viktimave te krimit te akuzuarit i caktohet taksa ne lartësi prej 30 euro te cilën është i obliguar ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmërisë,.

A r s y e t i m

Prokuroria themelore ne Prizren ka paraqitur aktakuzën PP.nr.2485-4/18 e dt. 23.01.2019 ndaj te akuzuarit A.B nga Prizreni për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK),

I pandehuri A.B në shqyrtimin fillestar , në tërësi ka pranuar veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës , e po ashtu ka pranuar edhe fajësinë .

Gjyqtari gjykues përcaktoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajit, pranimi është bere vullnetarisht, dhe mbështetet ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike dhe pas marrjes se mendimit nga ana e prokurorit te shtetit ka pranuar pranimin e fajësisë.

Kjo gjykatë gjeti se në veprimet e të akuzuarit , plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK),per te cilën ia shqiptoi dënimin me gjobe dhe dënimin e kushtëzuar me burg ne kohëzgjatje prej 1 (nje) viti i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen veprë te re penale, duke qenë e bindur se me këto lloje te dënimeve do te arrihet qëllimi i tyre.

Me rastin e shqiptimit të dënimit kjo gjykate pati parasysh si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur per veprat e kryera, premtimin se në të ardhmen nuk do te kryej me vepra penale, sjelljen korrektë para gjykatës ,kurse me rastin e shqiptimit te dënimit me gjobe vlersoi gjendjen e dobët ekonomiko-sociale te te pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është mare ne kuptim te nenit 450 dhe 452 te KPPK-se.

Vendimi mbi udhëzimin ne kontest civil u muar ne kuptim te nenit 463 par.2 te KPK.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të ketij aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2019:073867, 08.06.2020

G j y q t a r i

Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.